



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr.2047/1 prot.

Tiranë më 02.12.2022

Lënda: Dhënie mendimi për projektvendimin “Për miratimin, në parim të Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite në luftën kundër krimit”

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”), ka administruar shkresën tuaj me nr. 11908/1 prot., datë 24.11.2022, përmes së cilës kërkohet mendim për projektvendimin “Për miratimin, në parim të Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite në luftën kundër krimit”.

Fillimisht, Zyra e Komisionerit ju informon se, pika 1 e nenit 8 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), përcakton se “Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale kryhet, me marrës, nga shtete me një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale. Niveli i mbrojtjes së të dhënave personale për një shtet përcaktohet duke vlerësuar të gjitha rrethanat lidhur me përpunimin, natyrën, qëllimin dhe kohëzgjatjen e tij, shtetin e origjinës dhe destinacionin përfundimtar, aktet ligjore dhe standardet e sigurisë në fuqi në shtetin marrës. Shtetet, që kanë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, përcaktohen me vendim të Komisionerit”.

Ndërkohë, nga shqyrtimi i përmbajtjes së Vendimit nr. 8 datë 31.10.2016 të Komisionerit, “Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”, rezulton se Arabia Saudite nuk konsiderohet shtet me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, pasi nuk bën pjesë në këtë listë.

Në këto kushte, Zyra e Komisionerit vlerëson se transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale me një shtet, që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave

personale legjitimohet vetëm nëse plotësohet njeri nga kriteret e përcaktuar në pikën 2 të nenit 8 të Ligjit.

Më tej, nga shqyrtimi i përmbajtjes së materialit të vendosur në dispozicion konstatohet se, Marrëveshja nuk ka referenca ligjore lidhur me legjislacionin e aplikueshëm për mbrojtjen e të dhënave personale. Në nenin 6, janë përcaktuar vetëm disa detyrime për palët, në lidhje me konfidencialitetin dhe përdorimin e informacioneve që do të shkëmbehen midis tyre.

Lidhur me sa më sipër, Zyra e Komisionerit sugjeron se, pika 3 e nenit 6 të Marrëveshjes, duhet të riformulohet sipas përmbajtjes në vijim se: *“Palët që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të afatit të zbatimit të kësaj marrëveshjeje”*.

Me përfshirjen e sugjerimeve të mësipërme dhe në mënyrë të veçantë të një prej kriterëve të pikës 2 të nenit 8, Marrëveshja mund të vlerësohet e hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi